

D E K R E T
Nr.7493, datë 1.12.1990

PËR BANKËN SHQIPTARE TË TREGTISË

Neni 1

Banka Shqiptare e Tregtisë është person juridik, që ka për qëllim kryerjen e veprimtarisë bankare në përputhje me dispozitat e këtij ligji.

Qendra e Bankës Shqiptare të Tregtisë është në Tiranë. Për të kryer veprimtarinë Banka Shqiptare e Tregtisë ka rrejtin e saj.

Neni 2

Banka Shqiptare e Tregtisë ka këto të drejta e detyra:

a.merr pjesë në veprimtari dhe në marrëveshje me karakter ekonomik e finaciare që personat juridikë a fizikë shqiptar zhvillojnë e përfundojnë me personat juridikë a fizikë të huaj.

b.Vendos marrëdhënie dhe lidh marrëveshje bankare me bankat e tjera për çeljen dhe mbajtjen e llogarive në klering, me kompesim ose në valutë të lirë, si dhe mban depozita të bankave të tjera dhe depozita të saj pranë tyre.

c.Mban llogari bankare për arkëtimet dhe pagesat në valutë të huaj dhe në monedha kombëtare për llogari të klientëve të saj, si dhe kryen arkëtime dhe pagesa për veprime tregtare dhe jo tregtare.

d.Kryen këmbime valutore për nevojat e veta dhe të klientëve të saj brenda dhe jashtë shtetit.

e.Tregton tituj me vlerë dhe dokumente tregtare e finaciare.

f.Ndihmon dhe kontrollon klientët e saj në veprimtarinë e tyre, si dhe për zbatimin e ligjshmërisë në përdorimin e fondeve në valutë dhe monedhë kombëtare.

g.Lëshon dhe pranon llogari bankare.

h.Kryen investime në sektorë të ndryshëm të ekonomisë.

i.Krijon banka të përbashkëta dhe ndërmarrje ndryshme me fondet e saj.

j.Zhvillon veprimtari të tjera të ligjshme që parashikohen në statusin e saj.

Për shërbimet që kryen, Banka Shqiptare e Tregtisë mban komisione e shpenzime në valutë ose monedhë kombëtare, sipas natyrës së veprimit, në bazë të tarifave konkurruese përkatëse të miratuara prej saj.

Neni 3

Banka Shqiptare e Tregtisë jep kredi në monedhë kombëtare dhe në valutë me afatet e kushtet të përcaktuara prej saj dhe në bazë të vlerësimeve të veta.

Neni 4

Për investime që krediton, Banka Shqiptare e Tregtisë shqyrton dhe kontrollon studimet, projektet e preventivat dhe miraton dhënien e kredisë, në bazë të treguesve të leverdisshmërisë ekonomike. Ajo ndjek dhe kontrollon kryerjen e punimeve, vënien në shfrytëzim në afat të objekteve dhe realizimin e treguesve të efektivitetit deri në shlyerjen e kredisë.

Kur Banka vëren shkelje të rregullave ose shmangie nga qëllimi a destinacioni i kredisë, ajo pezullon ose ndërpret kreditimin, kërkon kthimin e para afatit të kredisë dhe urdhëron ndërprerjen e punimeve.

Nëse kredia nuk kthehet në afat ose nuk garantohet me vlerë materiale, Banka ndërpret e kufizon dhënien e kredisë ose kërkon khimin e mennjëhershëm të saj. Për kreditë e pakthyer në afat zbatohet interes më i lartë se për kreditë e rregullta.

Neni 5

Banka Shqiptare e Tregtisë ka këto organe:

- a. Këshilli Administrativ
- b. Drejtori i përgjithshëm dhe zëvendësit e tij.

Neni 6

Banka Shqiptare e Tregtisë drejtohet dhe përfaqsohet nga Drejtori i Përgjithshëm, i cili vepron në përputhje dhe brenda kompetencave që i jepen nga Këshilli Administrativ ose që përcaktohen në statutin e Bankës.

Banka Shqiptare e Tregtisë mund të përfaqsohet edhe nga persona të tjerë të autorizuar prej Drejtorit të Përgjithshëm.

Neni 7

Bankës Shqiptare të Tregtisë mund të çelë degë ose përfaqësi jashtë shtetit.

Neni 8

Degët e Bankës Shqiptare të Tregtisë në rrethe varet nga Drejtori i Përgjithshëm i Bankës Shqiptare të Tregtisë dhe për kryerjen e funksioneve e të detyrave ato kontrollohen e japin llogari para tij.

Neni 9

Për Bankën Shqiptare të Tregtisë shteti jep këto fonde:

- a. Për fondin e themelimit 600 milion lekë.
- b. Për fondin rezervë 200 milion lekë.
- c. Fondin e mjeteve kryesore.

Neni 10

Banka Shqiptare e Tregtisë organizohet sipas parimit me llogari më vete dhe i paguan shtetit tatimet e taksat e përcaktuara me ligj. Për pjesën tjetër të fitimit vendos Këshilli Administrativ i Bankës.

Banka Shqiptare e Tregtisë i nënshtrohet kontrollit të shtetit dhe bilanci i saj, pasi të jetë miratuar nga Këshilli Administrativ, i paraqitet Këshillit të Ministrave së bashku me një relacion shpjegues.

Neni 11

Banka Shqiptare e Tregtisë mban sekret të gjitha marrëdhëniet me klientët e saj në lidhje me depozitat e llogaritë e tyre dhe me veprimet që bëhen për to.

Neni 12

Me kërkesë të Bankës Shqiptare të Tregtisë, klientet i paraqesin asaj planet financiare, bilancet dhe çdo të dhënë tjetër për të bërë studime, analiza e kontrole me karakter ekonomik e financiar.

Neni 13

Drejtori i Përgjithshëm i Bankës Shqiptare të Tregtisë në bazë të dispozitave të këtij dekreti dhe për zbatim të tij, jep udhëzime që janë të detyrueshme për të gjithë klientët e saj.

Neni 14

Banka Shqiptare e Tregtisë ka vulën dhe shenjat e saj.

Neni 15

Ky dekret hyn në fuqi menjëherë.

Shënim: Titulli i këtij dekreti para se të ndryshohej nga Kuvendi Popullor ishte "Për Bankën Shtetit Shqiptar për Marrëdhëniet me Jashtë".